


STATUT

"DOMUS GROUP AL" SHPK



Njësia Administrative Nr. 5, Rr. "Pjetër Bogdani", P. 39/1, Ap. 3/7, Tiranë



STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DOMUS GROUP AL" SHPK

Me cilësinë e Ortakut të Vetëm Themelues, unë i nënshkruari **Z. Adrian HAJRO**, atësia Viktor, lindur në Tiranë, me dtl. 15-07-1966, me adresë: Nj. Bashkiake Nr. 5, Rr. "Ymer Kurti", P. 7, Sh. 1, Ap. 2, Tiranë, shtetësi shqiptare, me Letërnjoftim ID nr. 036917921-G60715240M, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

- mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 7850, dt. 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH" i ndryshuar, në Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, në Ligjin Nr. 131/2015 "Per Qendrën Kombëtare të Biznesit ", në Ligjin Nr. 10 081, dt. 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", si dhe në VKM Nr. 538 dt. 26.05.2009 si dhe në Aktin e Themelimi, të përpiluar dhe nënshkruar prej meje.

Ne datën 12.01.2022, kam themeluar Shoqërinë që do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e ndërtim-projektiveve civile dhe industriale me emërtimin "DOMUS GROUP AL" shpk.

KREU I - EMERTIMI, FORMA JURIDIKE, SELIA, KOHEZGJATIA, OBJEKTI, VULA

Neni 1-Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "DOMUS GROUP AL SHPK" shpk.

Neni 2 - Forma Juridike

Shoqëria është person juridik që do të fitojë personalitetin sikurse parashikohet në legjislacionin shqiptar në fuqi, menjëherë pasi te jete regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe në këto kushte Shoqëria do të jetë përgjegjëse ndaj të tretëve, për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj .

Shoqëria "DOMUS GROUP AL " shpk, është një shoqëri, kapitali i së cilës është i ndarë në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetëm person juridik, që mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të nënshkruar.

Neni 3 - Selia

Shoqëria do të ketë selinë ligjore në adresën: *Njësia Administrative Nr. 5, Rr. "Pjetër Bogdani", P. 39/1, Ap. 3/7, Tiranë.*

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filial, si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë .

Neni 4 - Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, jo më pak se 5 (pesë) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit .

Neni 5 - Objekti i veprimtarisë

Në përputhje me nenin 1, pika a dhe b, e ligjit Nr. 8770, dt. 19.04.2001, me ndryshimet përkatëse, objekti i shoqërisë do të jetë i përqendruar në:

- Projektim – Ndërtim objekteve civile dhe industriale



STATUT

“DOMUS GROUP AL” SHPK



A2022053970001035765

Njësia Administrative Nr. 5, Rr. “Pjetër Bogdani”, P. 39/1, Ap. 3/7, Tiranë

- Projektim - zbatim në punime interior, dekorim, fasada, restaurime.
- Import – Eksport, tregtim materiale dhe lëndë ndërtimi

Neni 6 - Vula

Shoqëria ka Vulën e saj, ne brendësi të së cilës shkruhet emërtimi i Shoqërisë “DOMUS GROUP AL” shpk. Te gjitha Aktet qe dalin nga Shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulën e Shoqërisë.

KREU II

Neni 7

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000 (NJËQIND MIJË) Lekë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë **Adrian HAJRO**, pronar i një kuote të vetme me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit të Shoqërisë. Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 8 - Mënyra e fitimit dhe kalimit të pronësisë të kuotave.

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :
 - a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
 - b) Shitblerje
 - c) Trashëgimisë
 - d) Dhurimit
 - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuara në ligj
2. Në rastin e kalimit të pronësisë mbi kuotat, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Çdo transferim i kuotave tek të tretet bëhet me vendim të ortakut të vetëm, duke redaktuar dhe akt noterial për transferimin e kuotave .

Neni 9 - Rritja e kapitalit

Shoqëria mund të rrite kapitalin themeltar në para ose në natyrë, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme ose mund të zvogëlojë atë, por jo përtej kufizimeve të parashikuara në Legjislacionin Shqiptar në fuqi. Shtimi ose zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë. Dokumenti depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit e cila bën ndryshimet përkatëse.

Neni 10 - Organi Vendimmarrës

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendim marrës i kësaj Shoqërie.

1. Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Ndryshimin e statutit;
 - c) Emërtimin e administratoreve;
 - d) Emërtimin dhe shkarkimin e likuidatorëve;
 - e) Emërtimin e shpërbllimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - g) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera me karakter administrativ;



STATUT

"DOMUS GROUP AL" SHPK



A2022053970001035765

Njësia Administrative Nr. 5, Rr. "Pjetër Bogdani", P. 39/1, Ap. 3/7, Tiranë

- h) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - i) Çështje të tjera të parashikuara në ligj.
2. Ortaku i vetëm merr vendime për çështjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatëse .
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në këtë regjistër duhet të regjistrohen:
- a) Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
 - c) Investimet;
 - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 11 - Administrimi

1. Administratori i shoqërisë "DOMUS GROUP AL AL" shpk me afat 5 vjeçar, me të drejtë përsëritje, emërohet Z. Adrian HAJRO.
2. Ortaku i Vetëm mund të emërojë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë pa qenë ortakë të Shoqërisë . Afati i emërimit të tyre nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërsëritje.
3. Në se ortaku i vetëm emëron më shumë se një administrator, ata i ushtrojnë bashkërisht kompetencat e administrimit të Shoqërisë .
4. Ortaku i vetëm mund të shkarkojë administratorin me vendim të posaçëm .

Neni 12 - Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Gjatë ushtrimit të funksioneve, administratori ka këto të drejta dhe detyrime:

- a. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare
- b. Përfaqëson Shoqërinë tregtare.
- c. Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë.
- d. Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente për miratim përpara Ortakut të Vetëm.
- e. Kryen regjistrimin dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit:
- f. Raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare .
- g. Kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe në statut.
- h. Njofton Ortakun e Vetëm për të marrë vendimet përkatëse në rastet kur nga bilanci vjetor apo raportet e ndërmjetme financiare, rezulton se ekziston rrezik që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme, brenda 3 muajve në vazhdim, si dhe nëq brenda 2 vjetëve të para të regjistrimit të Shoqërisë , ortaku i vetëm do të blejë një pasuri me një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara.
- i. Administratori, gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.



STATUT

"DOMUS GROUP AL" SHPK



A2022053970001035765

Njësia Administrative Nr. 5, Rr. "Pjetër Bogdani", P. 39/1, Ap. 3/7, Tiranë

- j. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe ligjin, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëme që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ai apo person tjetër, i lidhur me të kanë përfituar nga këto veprime të parregullta (në përputhje me nenin 98, pika 4 të Ligjit)
- k. Në interesin e mirë të shoqërisë në tërësi, administron çështjet për të cilat merret vendimi.
- l. Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent ose të mundshme të interesave personale me ato të Shoqërisë.
- m. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
- n. Me miratimin e Ortakut të vetëm themelues ka të drejtë të kryejë veprime bankare për llogari dhe në emër të Shoqërisë.

KREU IV - DREJTIMI EKONOMIK

Neni 13

Viti Financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përfundim bën viti i parë financiar i Shoqërisë, i cili fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mbyllet me 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 14 - Bilanci i Shoqërisë dhe dividendi

Brenda 6 muaj nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e Ortakut të Vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga administratori.

Mbledhja e Ortakut të vetëm vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jetë zbritur humbja e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 - Ekspertët

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë dhe dorëzojë në kohë, Ortakut të Vetëm për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimmarrëse që ka.

Neni 16 - Bilanci Kontabël

Bilanci kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga Ortaku i Vetëm, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre, por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të Shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë të rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçantë, etj.

Neni 17 - Dividendi

Të ardhurat neto që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore, të mësipërme dhe atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, mbeten, duke kaluar në pronësi të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.



STATUT

“DOMUS GROUP AL” SHPK



A2022053970001035765

Njësia Administrative Nr. 5, Rr. "Pjetër Bogdani", P. 39/I, Ap. 3/7, Tiranë

Neni 18 - Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është likuiduar, siç mund të jenë:

- humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj;*
- në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare "*
- kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare .*

Në këto raste, Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë - "Shoqëria në likuidim e sipër".

Neni 19 - Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja

Ortaku i vetëm i shoqërisë , që ben kalimin e trashëgimisë se tij ne kuadrin e operaconeve te permendura me lart , perfiton pjese te kapitalit themeltare nga shoqeria perfituese dhe sipas rastiote nje kompesim me para , vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10% te vleres nominale te kapitalit themeltar te dhene .

Operacionet e permendura me larte mund te realizohen nepermjet shoqerive te formave te ndryhme .

Bashkimi ose ndarja sjell prishje apo likudim te dhoqerise qe zhduket dhe kalimin e plote te trashegimise se saj te shoqerise perfituese ne gjendjen ne te cilen ndodhet bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerive qe zhduken marjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushtev te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes .

Neni 20

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentin që duhet depozituar në QKR.

Neni 21

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektin ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve/ debive që shoqëria ka ndaj shtetasve të vacante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 22

Shoqëria, mund të lidhë Kontrata me sektore shtetërore, drejtpërdrejt në tregun e lirë, si dhe me persona Juridike e Fizike vendas a të huaj.

Neni 23

Në veprimet kontraktuale Shoqëria përfaqësohet nga Administratori i saj. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata janë të detyrueshme për Shoqërinë.

Neni 24

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të cele llogari likuiduese pranë Bankave të vendit dhe të kryejë veprimet likuiduese nepermjet tyre.

50/19/2022



STATUT

"DOMUS GROUP AL" SHPK



A2022053970001035765

Njësia Administrative Nr. 5, Rr. "Pjetër Bogdani", P. 39/I, Ap. 3/7, Tiranë

Neni 25

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike shoqeria ka te drejte te vetfinancohet ne leke ose ne valute te huaj. Shkembimin e monedhes shqiptare ne monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar, ose ne tregun e lire privat te valutes.

Neni 26

Per pasqyrimin e aktivitetit, administratori ose persona te tjere te caktuar prej tij, jane te detyruar te mbajne dokumentacionin te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipas kerkesave te legjislacionit.

KREU V - MARREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 27

Ortaku themelues vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere te punesuar ne veprimtarine e Shoqerise .

Neni 28

Maredheniet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen sipas kontrates se punes qe lidhet midis paleve, ne perputhje me Legjislacionin shqiptar.

Neni 29

Marrja ne pune behet nga punedhenesi, ne perputhje me kerkesat e Kodit te Punes, duke bere regjistrimin ne Regjistrin e te punesuarve te shoqerise si dhe duke njoftuar organet e Zyres se Punes dhe te Inspektoriatit Shteteror ne juridiksionin ku ushtron aktivitetin Shoqeria.

Neni 30

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga administratori. Largimi lidhet me mbarimin e Kontrates se Punes, per shkak te shkeljeve disiplinore, ose me vete kerkesen e te interesuarit. Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirekuptimi s'eshte i mundur, palet i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per zgjidhje gjyqesisht.

KREU VI - TE PERGJITHSHME

Neni 31 - Baza ligjore.

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne peputhje te plote me Statutin e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar:

- Kushtetuta e Republikes se Shqiperise
- Kodi Civil
- Ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 131/2015 "Per Qendrën Kombëtare të Biznesit "
- Ligji 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise".
- Ligji nr. 1008 date 23.02.2009 "Per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqiperise"
- VKM nr 538 date 26.05.2009

STATUT

"DOMUS GROUP AL" SHPK

Njësia Administrative Nr. 5, Rr. "Pjetër Bogdani", P. 39/I, Ap. 3/7, Tiranë



A2022053970001035765

Neni 32 - Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti, si dhe cdo mosmarrëveshje qe mundet te linde midis shoqerise dhe te treteve do te jene kompetente Gjykatat Shqiptare.

Neni 33 - Dispozita Perfundimtare

Ky Statut u perpilua ne 4 ekzemplare me permbajte dhe vlerë të njëjtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe, pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga ortakut i vetem themelues i shoqerise tregtare "DOMUS GROUP AL SHPK" shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet origjinale duke vendosur emrin dhe firmen.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

Adrian HAJRO

ADRIAN Hajro